



POLITIKA MBI MBROJTJEN DHE SIGURINË E FËMIJËVE NË FUTBOLL

Shkurt 2023





PËRMBAJTJA:

I. Hyrje

II. Qasja jonë ndaj mbrojtës

1. Mbrojtja duhet të jetë praktike;
2. Mbrojtja duhet të jetë kontekstuale;

III. Kategoritë/Llojet e abuzimit;

IV. Gjashtë qëllimet e mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve:

- 1: Politika e mbrojtjes;
- 2: Parandalimi;
- 3: Rekrutimi i sigurtë dhe mbikqyrja;
- 4: Rritja e ndërgjegjësimit;
- 5: Raportimi i problemeve dhe shqetësimeve;
- 6: Matja e suksesit në mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve

V. Dispozitat Finale



**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO**

PËRKUFIZIMET:

FFK	Federata e Futbollit të Kosovës
FIFA	Organizata Ndërkombëtare e Futbollit
UEFA	Organizata Evropiane e Futbollit
PMSF	Politika për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Fëmijëve që luajnë futboll
PIKA E KONTAKTIT	Pika e Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve
SP	Sekretari i Përgjithshëm i FFK
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve



POLITIKA PËR MBROJTJEN DHE SIGURINË E FËMIJËVE NË FUTBOLL

I. HYRJE

Fëmijët janë pasuria e shtetit tonë dhe pjesa më e mirë e futbollit!

Për fëmijët tanë dhe sigurinë e tyre në futboll, FFK ka përgaditur këtë Manual, që njëherit është politikë e institucionit mbi temën e mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve.

Manuali bazohet mbi praktikat më të mira dhe rregullat e UEFAs, tregon vullnet të institucionit që të ruajë fëmijët në çdo segment të pjesëmarrjes së tyre në futboll, e ta bëjë futbollin të sigurtë për të gjitha moshat.

Mbrojtja e fëmijëve është një term që përfshinë si veprimet parandaluese për të minimizuar shanset e shfaqjes së dëmit, ashtu dhe veprimet reaguese për që siguruar, që kur linden shqetësime, ato të trajtohen ashtu sic duhen. Ky manual i përgjigjet nevojës për të marrë parasysh interesat më të mira të fëmijës në çdo veprim në lidhje me fëmijët e përfshirë në futboll (p.sh. vendime, trajnime, shërbime, dhe programe) dhe për të vepruar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor, në veçanti ku rastet e dyshuara mund të përbëjnë vepër penale.

Ky manual përbën një instrument të rëndësishëm për identifikimin e rreziqeve dhe ndihmën për të parandaluar ose minimizuar shanset e ndodhjes së dëmit, si dhe ndërmarrjen e masave të përgjegjshme për të siguruar që cdo incident të trajtohet në mënyrë të përshtatshme.

Politika e FFK-së do paraqitet në gjashtë kapitujt, duke vijuar me Kodin e Sjelljes dhe matësit e suksesit.

Përmes politikave tona, mbrojmë dhe ruajmë fëmijët, pasurojmë futbollin duke ngritur nivelin e sigurisë ashtu që sporti ynë më i dashur të jetë sport i të gjitha moshave.

Me këtë, ftojme të gjithë gocat dhe çunat që të na bashkohen në lojë, me besim të plotë në FFK që ruan ata dhe lojën e tyre!

Agim Ademi,

Kryetar i FFK-së



II. QASJA JONË NDAJ MBROJTJËS

1. Mbrojtja duhet të jetë praktike

- 1.1. Mbrojtja është më shumë se procedura dhe politika; është një mentalitet për të siguruar që fëmijët të jenë të sigurt dhe të mund të marrin pjesë në futboll në një ambient gjithëpërfshirës pa të gjitha format e abuzimit dhe dëmtimit.
- 1.2. Përpjeket e FFK-së jo vetëm që do rrisin kënaqësinë e fëmijëve nga futbolla dhe performanca e tyre, por gjithashtu do të vendosin themelet për të mbrojtur të gjithë të përfshirët në lojë.

2. Mbrojtja duhet të jetë kontekstuale

Mbrojtja është kontekstuale – procedurat dhe politikat duhet të përshtaten me situatën në fjalë. Zhvillimi i masave për mbrojtjen e fëmijëve kërkon një bashkëpunim me sektorë të ndryshëm si arsimi, shëndetësia, shërbimet sociale, drejtësia dhe zbatimi i ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Duhet të ketë angazhim me palë të ndryshme, duke përfshirë shkollat, familjet, mjekët, trajnerët, mësuesit, zyrtarët e sportit dhe bashkëmoshatarët, gjë e cila duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin vendor.

III. KATEGORITË/LLOJET E ABUZIMIT

1. Abuzimi fizik

- 1.1. Abuzimi fizik është forma më e shpeshtë dhe lehtë e njohur. Abuzimi fizik mund të jetë, por nuk kufizohet në cdo lloj goditjeje, dridhjeje, djegieje, shtrengimi, kafshimi, mbytja, gjuajtja, rrahja, ose veprim tjetër që shkakton lëndim fizik, lë shenja ose shkakton dhimbje.

2. Abuzimi seksual

- 2.1. Abuzimi seksual është cdo lloj kontrakti seksual ndërmjet një të rrituri dhe cdo personi më të ri se moshë 18 vjeq; ndërmjet një fëmijë dukshëm më të madh dhe një fëmijë më të vogël; ose nëse një person mbizotëron një tjetër, pavarësisht nga moshë. Është gjithashtu abuzive të bësh fotografi të pahijshme të fëmijëve, përfshirjen e fëmijëve në shikimin e imazheve ose aktiviteteve seksuale, ose inkujarimin e fëmijëve që të sillen në mënyra seksualisht të papërshtatshme. Bërja e komenteve të padëshiruara, vecanarisht ato që kanë natyrë seksuale, është gjithashtu një formë abuzimi seksual, i quajtur shpesh ngacmim seksual.

3. Abuzimi emocional, psikologjik ose verbal



- 3.1. Abuzimi emocional ndodh kur një i rritur i rëndësishëm në jetën e një fëmiju vazhdimisht e kritikon, kërcënon ose e shkarkon atë derisa të dëmtohet vetëvlerësimi i tyre dhe ndjenjat e vetëvlerësimit. Të bësh shaka gjithëmonë më dikë mund të jetë gjithashtu abuzive.
- 3.2. Kritika është e rëndësishme që fëmijët të mësojnë dhe të përmirësohen. Në mënyrë të ngjashme, shaka dhe të qeshura ndihmojnë në krijimin e lidhjeve midis njerëzve dhe mund të krijojnë një ndjenjë të shpirtit të ekipit. Ndryshimi është se abuzimi emocional shkon shumë larg. Kritika pushon së qeni motivuese dhe shakatë nuk janë qesharake. Abuzimi emocional mund të dëmtojë dhe shkaktojë dëm, ashtu sic bën abuzimi fizik.

4. NEGLIZHIMI

- 4.1. Neglizhimi ndodh kur një i rritur nuk ofron mbështetjen e mjaftueshme emocionale ose i kushton qëllimisht dhe vazhdimisht shumë pak ose aspak vëmendje një fëmiju. Neglizhimi ndodh gjithashtu kur një fëmijë nuk i jepet udhëqimi, strehimi, rrobat, kujdesi mjekësor ose mbikëqyrja e duhur.
- 4.2. Ka forma të tjera të abuzimit si diskriminimi, shfrytëzimi dhe dhuna, por këto bëjnë pjesë në katër kategori kryesore të abuzimit.

5. BULLIZIMI/NGACMIMI

- 5.1. Ngacmimi mund të marrë shumë forma. Mund të përfshijë akte fizike si goditja, aktivitete në internet, të tilla si mesazhe abuzive, komente, ose imazhe të postuara në rrjete sociale, dëmtimi. Ngacmimi mund të bazohet në gjininë, përkatësinë etnike, seksualitetin ose paaftësinë e dikujt ose aftësinë e tyre sportive. Ngacmimi mund dhe shkakton dëm. Është e rëndësishme të krijohet një atmosferë ku të gjithë e dinë se ngacmimi nuk tolerohet dhe ta ndalojë atë sapo të fillojë.

IV. GJASHTË QËLLIMET E POLITIKËS PËR MBROJTJEN DHE SIGURINË E FËMIJËVE

- 1: Politika e mbrojtjes;
- 2: Parandalimi;
- 3: Rekrutimi i sigurisë dhe mbikëqyrja;
- 4: Rritja e ndërgjegjësimit;
- 5: Raportimi i problemeve dhe shqetësimeve;
- 6: Matja e suksesit në mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve



QËLLIMI 1: POLITIKA E MBROJTJES

1. Përgjegjësia

- 1.1. Mbrojtja dhe siguria është përgjegjësi e të gjithëve.
- 1.1. Çdonjëri që punon për /apo për llogari të FFK, pavarësisht nga niveli, kapaciteti apo puna që kryen, duhet të njohë e pranojë detyrën e tij për të mbrojtur dhe nxitur mirëqenien dhe interesin e fëmijëve, gjithashtu dhe përgjegjësinë e tyre për të ndërmarrë hapat e duhura për të zbatuar këtë politikë.

2. Përkufizimi i “mbrojtjes dhe sigurisë”

- 2.1. Mbrojtja dhe siguria përkufizuar si përgjegjësia e organizatës (FFK) për të përmbushur dhe garantuar që futboli është një eksperiencë e sigurt, pozitive dhe e pëlqyeshme për të gjithë fëmijët dhe se të gjithë fëmijët mbahen të sigurt nga dëmtimet (përfshirë abuzimin) kur angazhohen në futboll, në të gjitha kapacitetet dhe nivelet.
- 2.2. Mbrojtja dhe siguria e fëmijëve përfshin si veprimet parandaluese për të minimizuar shanset e ndodhjes së dëmtimeve dhe veprimet përgjegjëse synojnë që, në rast se shqetësimet rriten, atëherë ato trajtohen në mënyrën e duhur. Kjo pasqyron nevojën për të promovuar interesat e fëmijëve dhe përputhet si me standardet ndërkombëtare ashtu dhe me legjislacionin vendas, veçanërisht lidhur me shqetësimet për akte të mundshme kriminale.
- 2.3. Për qëllimet e kësaj politike dhe në harmoni me konvetat ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi, “fëmijë” do të konsiderohet çdo qenie njerëzore që nuk ka arritur moshën 13.

3. Parandalimi i dëmtimit dhe abuzimit ?

- 3.1 Çdonjëri që punon për dhe në emër të FFK, pavarësisht nga niveli, kapaciteti apo puna që kryen, duhet të dijë se çështjet e abuzimit, dëmtimit dhe mbrojtjes e sigurisë së fëmijëve, rrallë janë ngjarje më vete që mund të mbulohen nga një përkufizim apo etiketim. Në shumicën e rasteve çështje të ndryshme mbivendosen me njëra tjetrën.
- 3.2 Dëmtimi mund të ndodhë në shumë mënyra dhe në përgjithësi do të thotë se siguria dhe mirëqenia e fëmijës është rrezikuar. Kjo mund të jetë sepse dikush me qëllim zgjedh të keqpërdorë autoritetin apo besimin e tyre dhe të abuzojë me fëmijën, ose mund të jetë për shkak të eksperiencës së pakët (e shkaktuar potencialisht nga mungesa e ndërgjegjësimit dhe trajnimit (psh. paaftësia apo mosveprimi për të mbikëqyrur fëmijët).



- 3.3 Abuzimi është keqtrajtimi i një fëmije që shkakton, ose mund të shkaktojë, dëmtim të fëmijës. Një person mund ta dëmtojë një fëmijë duke i shkaktuar vetë dëmtim ose duke mos vepruar për ta parandaluar dëmtimin e shkaktuar nga dikush tjetër. Fëmijët mund të abuzohen nga njerëz që janë të njohur me ta, si në një mjedis familjar apo mjedis institucional e komunitar. Ndryshe ndoshta më rrallë ata mund të abuzohen edhe nga të panjohur (psh..nëpërmjet internetit). Ata mund të abuzohen nga një apo disa të rritur si edhe nga një apo disa fëmijë të tjerë.
- 3.4 Abuzimi mund të marrë forma të ndryshme dhe përfshin të gjitha llojet e abuzimit fizik, emocional/psikologjik dhe seksual, trajtimi neglizhent dhe i pakujdesshëm, dhuna dhe shfrytëzimi, pavarësisht në se shkaktohen nga personi apo online.
- 3.5 Megjithëse çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve perceptohen zakonisht si një keqtrajtim i fëmijës nga një i rritur, fëmijët mund të jenë gjithashtu edhe autorë. Kjo ndodh normalisht kur një fëmijë është në një pozitë pushteti apo influence (psh sepse ata janë më të mëdhenj në moshë ose kanë autoritet – si në rastin kur ata janë në pozicionin e kapitenit të ekipit) dhe shpesh kjo referohet si “ngacmim/bullizëm”.
- 3.6 Në rastet e ngacmimit/bullizmit, është e nevojshme që edhe të mbështetet fëmija përpara se të ngacmohet edhe të mendohet se cila është mënyra më e mirë për tu marrë me fëmijën që është ngacmuesi, me qëllim që të sigurohemi se asnjë fëmijë tjetër nuk do të dëmtohet, dhe se mirëqenia dhe interesat e të dy fëmijëve do të promovohen.

4 Rreziqet e Mbrojtjes dhe Sigurisë në Futboll?

- 4.1 Janë disa situata shumë specifike ku mund të shfaqen dëmtimi dhe abuzimi në futboll.
- 4.2 **DËMTIMET FIZIKE:** Çdo sport përfshin disa rreziqe të dëmtimeve fizike dhe futbollit nuk bën përjashtim nga kjo. Megjithatë, dëshira për të arritur sukses dhe për të fituar nuk do të thotë që fëmijët mund të shtyhen përtej arsyes apo asaj që është tej kufijve të moshës dhe nivelit të aftësisë së tyre.
- 4.3 **PRESIONI I PERFORMANCËS:** Fitorja është një pjesë e rëndësishme e futbollit. Megjithatë, nxitja dhe shtytja e fëmijëve për të performuar dhe vendosja e tyre nën një presion ekstrem për të arritur sukses mund të jetë e dëmshme nga ana psikologjike, emocionale dhe fizike.
- 4.4 **PËRKUJDESJA FIZIKE:** Ndërrimi i dhomave, dusheve dhe situatat që përfshijnë kontaktet e ngushta fizike (psh fizioterapia dhe trajtimet e tjera) mund të japin mundësi për ngacmime, fotografi apo filmime të papërshtatshme dhe abuzim seksual.
- 4.5 **UDHËTIMET GJATË NATËS:** Udhëtimet natën mund të paraqesin shumë rreziqe potenciale, që përfshijnë mbikëqyrjen jo të duhur ndaj fëmijëve që mungojnë, aksesin ndaj pijeve alkoolike apo përmbajtjeve të papërshtatshme televizive, problemeve të përdorimit të mediave e rrjeteve sociale.



4.6 **MARRËDHËNIET E NGUSHTA/AFËRTA:** Marrëdhëniet e ekipit me trajnerin dhe stafin mbështetës (siç janë fizioterapistët dhe doktorët) janë një aspekt i rëndësishëm dhe përfutues i futbollit. Shumë fëmijë zhvillojnë marrëdhënie të ngushta dhe besimi me trajnerët e tyre, që janë shpesh njerëz të rëndësishëm në jetën e tyre, veçanërisht në rast se fëmijët nuk kanë marrëdhënie pozitive, mbështetëse me të rriturit e tjerë. Megjithatë, ndërsa shumë trajnerë nxisin fuqizimin e marrëdhënieve që janë në interesin më të mirë të fëmijëve nën kujdesin e tyre, përsëri ka mundësi abuzimi me autoritetin dhe besimin që mund të dëmtojë fëmijët.

5 Parimet kryesore të mbrojtjes dhe sigurisë?

- 5.1. Futbollit duhet të jetë një eksperiencë e sigurt, pozitive dhe e kënaqshme për të gjithë fëmijët.
- 5.2. Të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për mbrojtje dhe siguri dhe promovim të mirëqenies dhe pjesëmarrjes, pavarësisht nga mosha, gjinia, orientimi seksual, prejardhja etnike apo sociale, feja dhe niveli i aftësisë apo paaftësisë.
- 5.3. Të gjitha veprimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve duhet të merren në interesin më të mirë të fëmijëve.
- 5.4. Të gjithë kanë përgjegjësi për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve. Edhe vetë fëmijët mund të luajnë një rol për të ndihmuar për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre dhe të fëmijëve të tjerë, megjithëse përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen dhe sigurinë e kanë të rriturit.
- 5.5. Masat mbrojtëse duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese, duke njohur faktin se disa fëmijë (siç janë ata me aftësi të kufizuara) mund të jenë në një rrezik në rritje abuzimi.
- 5.6. Transparenca dhe sinqeriteti është thelbësor kur bëhet fjalë për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve. Kur stafi, vullnetarët, partnerët, fëmijët, familjet dhe anëtarët e komunitetit nuk janë të aftë të ngrenë shqetësimet dhe problemet atëherë mund të rritet abuzimi dhe dëmtimi i fëmijëve.
- 5.7. Të gjitha shqetësimet lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet të merren seriozisht. Kur është e domosdoshme duhet të ndërmerren të gjitha hapat e duhura për të mbrojtur fëmijët, duke përfshirë edhe referimin tek agjencitë e zbatimit të ligjit dhe mbrojtjes së fëmijëve.
- 5.8. Asnjë organizatë nuk mund të mbrojë fëmijët duke punuar e vetme dhe e izoluar, prandaj është e rëndësishme të punohet me organizatat e tjera, agjencitë qeveritare (psh drejtoritë dhe ministritë me mandat për të mbrojtur fëmijët) dhe grupet e tjera përkatëse.



- 5.9. Duhet të ruhet konfidencialiteti dhe detajet personale të gjithë atyre që përfshihen (duke futur emrin e personit që ngriti problemin, fëmijës që ka problem dhe të dyshuarin e mundshëm) duhet të mbahen të fshehta, përveçse në rastet që duhet përcjellë informacioni për të siguruar që fëmija është i mbrojtur (psh në rastet kur është kryer vepër penale).
- 5.10. Të gjitha veprimet mbrojtëse duhet të ndërmerren brenda politikave dhe kornizave ligjore përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

QËLLIMI 2: PARANDALIMI

1. Miratimi i politikës së mbrojtjes dhe sigurisë

- 1.1. FFK miraton politikën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe ndan të njëjtën me të gjitha nivelet e udhëheqësisë së FFK-së.
- 1.2. Çdo punëtor i FFK-së duhet të veprojë në pajtim me këtë Politikë.
- 1.3. Ky dokument është i disponueshëm në gjuhën shqipe dhe atë serbe.

2. Identifikimi i Pikave të Kontaktit për Mbrojtjen dhe Sigurinë

- 2.1. FFK do të identifikojë një pikë kontakti për zbatimin e kësaj Politike.
- 2.2. FFK do të sigurohet që fëmijët, gjatë ushtrimit, lojës apo aktiviteteve të tjera që ndërlidhen me futbollin, këtu përfshirë personat të cilët në mënyrë direkte apo indirekte punojnë me fëmijët e janë të punësuar nga FFK, gëzojnë trajtimin e dinjitetshëm, janë të mbrojtur nga çdo formë e sjelljes që rrezikon mirëqenien e tyre apo shëndetin e tyre fizik apo mendor, janë të mbrojtur nga çdo lloj diskriminimi dhe bullizimi.
- 2.3. Për të siguruar implementimin e paragrafit paraprak, FFK do kërkojë, përmes pikës së kontaktit, përgjegjësi me shkrim në baza javore, nga të gjithë personat të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë punojnë me fëmijët.

QËLLIMI 3: REKRUTIMI I SIGURTË DHE MBIQYRJA

1. Procedurat e rekrutimit të sigurt, do të prezantohen për të përmbushur identifikimin e aplikantëve që mund të paraqesin rrezik për fëmijët dhe parandalimin e tyre për të punuar me fëmijët.
- 1.1. Për të parandaluar njerëzit e papërshtatshëm për të punuar me fëmijët, asnjëri nuk duhet të fillojë nga puna me fëmijët derisa të përfundojnë proceset e rekrutimit të sigurt,



verifikimet e historikut dhe pasi të kenë përfunduar të gjithë trajnimet mbi politikën e mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve.

- 1.2. Të gjitha procedurat e rekrutimit të sigurt dhe verifikimeve (siç janë referencat) duhet të dokumentohen dhe regjistrohen në dosjen përkatëse. Informacioni i grumbulluar duhet të ruhet dhe asgjësohet në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi të ruajtjes së të dhënave.
- 1.3. Dosjet e rekrutimit do jenë të qasshme për prindërit apo stafin e FFK-së që ngrit dyshimin lidhur me zbatimin e kësaj Politike nga ndonjë punëtor i FFK-së që punon me fëmijën.

2. Kodi i Sjelljes

- 2.1. Për njerëzit që punojnë për/ dhe në emër të FFK aplikohen kode të qarta sjellje. Këto vendosin pritshmëri të qarta në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve si dhe detajet që priten për sjelljet e ndaluara. Më i detajuar Kodi i Sjelljes është bashkëlidhur si aneksi 2 i kësaj politike.
- 2.2. Çdo përfshirje me FFK dhe aktivitetet e organizuara nga kjo organizatë do të varen nga individi në fjalë, duke nënshkruar dhe rënë dakord me klauzolat e këtyre kodeve të sjelljes, të cilat do ti bashkëlidhen të gjitha kontratave të punësimit.
- 2.3. Të gjitha shkeljeve të kodit të sjelljes do tu përgjigjen pa vonesë, me informacione që do të mbahen rreptësisht konfidenciale dhe, bazuar në parimin e “nevojës për njohje”, në përputhje me procesin e duhur të punësimit dhe kërkesave ligjore.
- 2.4. Në rast se do të dyshohet ose informohet për shkelje të kodit të sjelljes, nga ekipi i mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve të themeluar nga pika e kontaktit të zbatimit të kësaj Politike sipas aprovimit të FFK-së, mund të kërkohet hetim nga një person i pavarur dhe asnjansës me ekspertizë të posaçme në këtë fushë, i cili do të vazhdojë hetimin në përputhje me procedurën zyrtare në fuqi.
- 2.5. Si pjesë e kësaj përgjigje, FFK do të marrë masat e duhura kundër autorit për dëmtimin e të drejtave të fëmijëve apo për mosrespektim të rregullave të FFK-së.
- 2.6. Gjithmonë duhet të mbahet në konsideratë vlerësimi i rrezikut për fëmijët dhe fakti në se autori apo autorët e përfshirë duhet të pezullohen nga organizata në pritje të rezultateve të hetimit përkatës.
- 2.7. Kodet e Sjelljes do të përfshijnë masa disiplinore specifike për mosrespektimin e tyre. Këto masa mund të variojnë nga paralajmërimi ose pezullimi, kombinuar me trajnim shtesë dhe masa që rrisin ndërgjegjësimin, deri tek pushimi nga puna.
- 2.8. Kodet e Sjelljes zbatohen pa paragjykuar ndonjë sanksion të mundshëm penal.



3. Mbikqyrja

- 3.1.** Në përgjithësi, puna vetëm për vetëm me fëmijët duhet të shmanget. Kur punohet me fëmijët duhet të jenë gjithmonë prezent të paktën dy të rritur. Pranohet që kjo nuk është gjithmonë e mundur, por të rriturit duhen që gjithmonë të punojnë në një mënyrë apo vend të hapur ku ata të mund të shihen nga të tjerët, preferohet puna me grupe fëmijësh, se sa puna individuale me fëmijë vetëm për vetëm.
- 3.2.** Një numër i mjaftueshëm i të rriturve duhet të jetë gjithmonë prezent për të siguruar mbikëqyrjen e duhur të fëmijëve, duke pasur parasysh kontekstin dhe moshën dhe kapacitetet e fëmijëve përkatës. Çështjet e lidhura me mbikëqyrjen dhe punën vetëm për vetëm duhen të mbahen gjithmonë në konsideratë si pjesë e çdo vlerësimi rreziku.
- 3.3.** FFK rekomandon ndarjen proporcionale të rritur-fëmijë si më poshtë:
- 1 i rritur për 10 fëmijë të moshës 13 deri 18 vjeç
 - 1 i rritur për 8 fëmijë të moshës 9 deri 12 vjeç
 - 1 i rritur për 6 fëmijë të moshës 5 deri 8 vjeç
 - 1 i rritur për 3 fëmijë të moshës 4 vjeç e poshtë.
- 3.4.** Në rastet kur numri i të rriturve nuk mjafton për të arritur nivelin e kërkuar të mbikëqyrjes, atëherë aktiviteti do të anulohet.
- 3.5.** Në rastet kur jepet ndihmë apo përkujdesje mjekësore intime, fëmijët janë të detyruar të marrin një fëmijë tjetër apo të rritur sipas pëlqimit të tyre për të qenë prezent.
- 3.6.** Kërkesat e qarta specifike për mbledhjen e mostrave të antidopingut nga minorenët duhet të respektohen gjatë procedurës së testit. Sportistët që janë minorenë duhet të njoftohen për përzgjedhjen e tyre për kontrollin doping në prezencë të një të rrituri dhe mund të zgjedhin të shoqërohen nga një përfaqësues i ekipit gjatë gjithë sezonit të mbledhjes së mostrave. Në rast se sportisti minoren refuzon që të ketë një përfaqësues nga ekipi gjatë mbledhjes së mostrave, atëherë duhet një dëshmitar tjetër që të jetë prezent gjatë mbledhjes së mostrave të urinës për të vëzhguar oficerin e kontrollit të dopingut.
- 3.7.** FFK dhe shoqatat apo klubet pjesëmarrëse në aktivitetet dhe kompeticionet e organizuara nga UEFA, FIFA, FFK për moshat nën 18 vjeç (U18, U17, U16, U15, U14 etj. të çdo lloji kategorie) marrin përsipër të sigurojnë që formulari i njohjes dhe marrëveshjes për të miturit është plotësuar si duhet dhe është nënshkruar nga secili i mitur pjesëmarrës. Formularët e plotësuar duhet të mbahen nga organizata, shoqata apo klubet dhe dorëzohen në FFK sipas kërkesës.
- 3.8.** Fëmijëve nuk është e nevojshme tu jepet kujdes personal (psh ndihmë për tu larë) në rast se ata i kanë mundësitë për tu kujdesur vetë për vetveten.



- 3.9. Dhomat e zhveshjes, dushet, etj. duhet te mbikëqyret, por në mënyrë të tillë që të bëhet e mundur mbrojtja e privatësisë së fëmijëve. Vetëm të rriturit përgjegjës për mbikëqyrjen e fëmijëve duhen të jenë në dhomat e zhveshjes në kohën kur ndërrohen fëmijët. Askush tjetër (psh fotografët) nuk duhet të jetë në këto dhoma ndërsa fëmijët janë duke u ndërruar. Atyre u duhet thënë se kur duhet të hyjnë dhe kur duhet të largohen.
- 3.10 Gjatë qëndrimeve natën (psh në lidhje me ndeshjet në fushën kundërshtare dhe kampet e trajnimit), fëmijët nuk duhet të flenë në të njëjtën dhomë ku flenë mbikëqyrësit e rritur, vetëm në rastet kur fëmija është i afërm, familjar i të rriturit ose kur i rrituri është caktuar të veprojë si roje e fëmijës nga prindërit apo kujdestarët.
- 3.11. Duhet të vendosen procedura të qarta për rastet kur një fëmijë humbet apo nuk gjendet ose kur prindi apo kujdestari nuk arrin ta marrë fëmijën.
- 3.12. Në rast se fëmija mund të udhëtojë i vetëm për në aktivitet dhe kthim, nga prindi apo një person që e ka autoritetin (psh kujdestari ligjor) duhet të merret një leje me shkrim.
4. **Vizitorët, përfaqësuesit e mediave, në FFK, kompeticionet e të rinjve dhe aktivitetet e tjera**
- 4.1. FFK dhe çdokush i ngarkuar nga ajo për të luajtur një rol brenda organizatës dhe kompeticionet e të rinjve duhet të sigurojë që çdo vizitor, për të cilët ata janë përgjegjës (duke përfshirë përfaqësuesit e medias) është njohur dhe i kupton parimet e Politikës dhe është dakord me termat dhe kushtet e kësaj politike përpara se të vizitojë vendin e eventit.
- 4.2. Vizitorët (duke përfshirë përfaqësuesit e medias) duhet gjithmonë të jenë të shoqëruar dhe duhet të lihen pa u mbikëqyrur me fëmijët vetëm në rrethana të veçanta (psh në se po kryejnë intervista, kërkime, hulumtime). Në këto raste duhet të merren masa shtesë për të siguruar që vizitori apo vëzhguesi nuk përbën rrezik për fëmijët.
- 4.3. Siguria dhe mirëqenia e fëmijëve nuk duhet të kompromentohet nga media. Asnjë informacion privat siç janë adresat nuk duhet tu jepet përfaqësuesve të medias.
- 4.4. Përdorimi i imazheve dhe historive të fëmijëve nga media apo persona të tjerë, duhet të bëhet vetëm me lejen si të fëmijëve ashtu edhe të personave që janë përgjegjës për ta (siç janë prindërit).
- 4.5. Nuk duhet të përdoren apo shpërndahen imazhet e fëmijëve që janë ofenduese apo shfrytëzuese (duke përfshirë imazhet e një fëmije që nuk është i veshur plotësisht).
5. **Mbrojtja dhe siguria online**



- 5.1. Duhet të kryhen vlerësime rreziku lidhur me përdorimin e teknologjisë dhe medias dhe ndikimin e tyre në sigurinë e fëmijëve si dhe të përcaktohen hapat që duhet të merren për të eliminuar apo minimizuar këto rreziqe.
- 5.2. FFK do të sigurojë udhëzime mbi përdorimin e duhur të teknologjisë (interneti, telefonat celularë, media sociale etj.) në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve dhe zbatimin e kësaj politike.
- 5.3. Kudo që një fëmijë mund të ketë akses në internet, duhet të instalohen filtra apo programe bllokuese për të siguruar që fëmijët nuk mund të aksesohen në faqe të papërshtatshme, me materiale ofenduese. Në rast se është e mundur faqet që nxisin abuzimin e fëmijëve apo përmbajnë imazhe dhe informacione të dëmshme për fëmijët duhet të bllokohen në të gjitha ambientet dhe rrjetet e kontrolluara nga FFK. Në rast se kjo nuk është e mundur teknikisht atëherë të rriturit përgjegjës për të punuar më fëmijët duhet të sigurohen që fëmijët nuk do të aksesohen në rrjete të pakontrolluara ose në telefona celularë gjatë kohës së aktivitetit duke u mbajtur vazhdimisht nën mbikqyrje.
- 5.4. Në rast se merren materiale ofenduese apo të padëshirueshme, duhet të njoftohet menjëherë Pika e Kontaktit dhe pastaj duhet të informojnë për këtë problem ekipin e sigurisë të IT, në mënyrë që ata të përmirësojnë sigurinë e rrjetit të internetit dhe të raportojnë tek agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit. Mbanë parasysh se materiale apo mesazhet në fjalë nuk duhet të dërgohen në rrugë elektronike si pjesë e kallëzimit të rastit, pasi kjo mund të përbëjë vepër penale sipas ligjit ndërkombëtar.

QËLLIMI 4: RRRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT

1. Rritja e ndërgjegjësimit dhe trajnimi

- 1.1. Çdonjëri që punon për dhe në emër të FFK, duke përfshirë shoqatat, klubet profesioniste dhe amatore të lidhura me to, gjithashtu edhe komunitetet, familjet, fëmijët dhe aktorët e tjerë të përfshirë, duhet të vihen në dijeni për Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe duhet të kuptojnë si të njohin abuzimin me fëmijët dhe të raportojnë shqetësimet.
- 1.2. FFK do të bëjë të mundur sigurimin e moduleve të trajnimit të dedikuara për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve (si online dhe offline), përdorimin e moduleve vazhdues të zhvilluara nga UEFA për të mbështetur FFK, shoqatat, klubet profesioniste dhe amatore të lidhura me to.
- 1.3. Vëmendje e veçantë do ti jepet rritjes së ndërgjegjësimit të fëmijëve për këtë politikë dhe mënyrave të ndryshme se si ata mund të ndihmojnë për të rritur sigurinë e tyre. Kjo mund



të përfshijë zhvillimin e një versioni më miqësor për fëmijët të politikës dhe moduleve të trajnimit në bashkëpunim me vetë fëmijët.

- 1.4. Mund të organizohen trajnime të specializuara mbi mirëqenien, mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve, në varësi të natyrën e punës dhe rolit përkatës të stafit, vullnetarëve, trajnerëve etj. si dhe historikut dhe eksperiencës së tyre.
- 1.5. FFK do të sigurojë në mënyrë të rregullt azhurnime mbi mbrojtjen e fëmijëve si në rrugë zyrtare (p.sh. në formë trajnimi apo mbikqyrje) ashtu dhe jo zyrtare (p.sh. nëpërmjet diskutimeve në mbledhjet e ekipeve).
- 1.6. Pavarësisht se FFK jep udhëzime dhe trajnime mbi këtë politikë lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat që janë specifike për rolet individuale, të gjithë të rriturit kane përgjegjësi personale për të kërkuar sqarime dhe këshilla të mëtejshme në rast se ata nuk janë të qartë për atë që kërkohet prej tyre dhe rolit të tyre. Ekipi i Mbrojtjes dhe Sigurisë së Fëmijëve në FFK ose PIKA E KONTAKTIT është pika e parë e kontaktit për kërkesa të tilla.
- 1.7. Për të gjitha sesionet e trajnimit dhe orientimit që janë kryer duhet të mbahen dokumentacioni (rekordet duhet të përfshijnë datat dhe listat e pjesëmarrësve). Këto rekorde duhet të ruhen në përputhje me procedurat përkatëse për menaxhimin e të dhënave.

2. Vlerësimet e rrezikut

- 2.1. Vlerësimet e rrezikut janë një element i rëndësishëm i çdo procesi për mbrojtjen e fëmijëve. Ato formojnë bazat për veprimet parandaluese duke bërë të mundur që aktivitetet janë të sigurta, dhe se çdo rrezik i identifikuar është eliminuar apo minimizuar dhe ato gjithashtu përcaktojnë veprimet specifike që duhet të ndërmerren në rastet kur shfaqen probleme të sigurisë së fëmijëve.
- 2.2. Në rastet e aktiviteteve të organizuara (siç janë kompeticionet/garat), vlerësimi i rrezikut duhet të ndërmerret për të identifikuar çdo rrezik potencial, shoqëruar me një plan për ti minimizuar këto rreziqe. Përgjegjësia e kryerjes së analizës së rrezikut i mbetet personit që ka përgjegjësinë më të madhe për aktivitetin (nivelit më të lartë).
- 2.3. Në rast se vlerësimi arrin në konkluzionin se ka shumë rreziqe që nuk mund të reduktohen në një nivel të pranueshëm, aktiviteti nuk duhet të vazhdojë.
- 2.4. Përpara se fëmijët të marrin pjesë në aktivitetet fizike, atyre duhet tu merren detajet e kontaktit për rastet emergjente dhe informacioni mjekësor dhe ky informacion duhet ti mundësohet çdo personi që ka për detyrë të kujdeset për këta fëmijë gjatë eventit.



- 2.5. Masat e menaxhimit të rrezikut rishikohen në baza të rregullta si gjatë ashtu dhe në përfundim të aktiviteteve, në mënyrë që mësimet e nxjerra të mund ti përdorim në aktivitetet e ardhshme dhe të bëjmë ndryshimet e duhura.

3. **Krijimi i një kanali të sigurt për ngritjen e shqetësimeve**

- 3.1. Duhet të krijohet një procedurë e qartë për raportimin e shqetësimeve dhe ti komunikohet kujtdo që punon me FFK-në, duke përfshirë fëmijët, familjet dhe komunitetet.
- 3.2. FFK-ja garanton konfidencialitetin e plotë të procesit dhe dokumenteve në të cilat do të kishte akses si pjesë e procedurës joformale.
- 3.3. Nëse shqetësimet ngrihen por nuk vertetohen, nuk duhet të ndërmerret asnjë veprim ndëshkues ndaj personit që ngre këto shqetësime, me kush që të mos ketë pasur qëllim keqdashës.
- 3.4. Regjistrimet me shkrim të të gjitha raporteve të marra (madje dhe raportet e paqarta) duhet të mbahen në një vend të sigurt, konfidencial.
- 3.5. Të gjitha shqetësimet e ngritura do të merren seriozisht dhe do tu përgjigjen në përputhje me këtë politikë mbrojtëse dhe procedurat e përcaktuara sipas kësaj politike.

QËLLIMI 5: RAPORTIMI I PROBLEMEVE DHE SHQETËSIMEVE

1. **Krijimi i një mjedisi të hapur pune**

- 1.1. Në rast se kërkohet mbështetje ose këshilla për mbrojtjen e fëmijëve kjo duhet të merret seriozisht. Kërkimi i këshillës apo mbështetjes asnjëherë nuk duhet konsideruar si tregues që dikush nuk ka aftësi apo njohuri apo se po përhap thashetheme, etj.
- 1.2. Në rast se personat që punojnë për apo në emër të FFK përfshihen në incidentet e mbrojtjes së fëmijëve – qoftë si subjekte të një hetimi apo si dëshmitarë – atyre duhet tu jepet mbështetja e duhur. Kjo mund të përfshijë mbikëqyrjen shtesë apo këshillimin.

2. **Raportimi i incidenteve dhe masat e mëtejshme**



- 2.1. Raportimi, hetimi dhe menaxhimi i incidenteve për mbrojtjen e fëmijëve duhet të jetë në përputhje me ligjin vendas në fuqi. Kur merret në konsideratë referimi i një fëmije tek një agjenci për mbrojtjen jashtë vendit, duhet të mbahen gjithmonë parasysh struktura ligjore në vendin përkatës dhe interesi më i mirë dhe dëshira e fëmijës.
- 2.2. Prandaj do të përfshihen në këtë proces vetëm njerëzit pjesëmarrja e të cilëve është e domosdoshme për të hetuar shqetësimet apo mbështetur fëmijën, qoftë nga ana mjekësore apo psikologjike. Duhet të përpilohet një procesverbal për secilën ndërhyrje, i cili nënshkruhet nga personat e përfshirë dhe i dërgohet ekipit për mbrojtjen e fëmijëve në FFK.
- 2.3. Referimet tek agjencitë lokale për mbrojtjen e fëmijëve dhe ato të zbatimit të ligjit duhet të bëhen në mënyrën e përshkruar nga agjencia. (agjencitë psh mund të kenë një format të preferuar raportimi). Në rast se referimi kryhet verbalisht/ me gojë, ai duhet të konfirmohet gjithashtu edhe me shkrim.

QËLLIMI 6: MATJA E SUKSESIT NË MBROJTJEN DHE SIGURINË E FËMIJËVE

- 1.1. Përgjegjësinë përfundimtare për zbatimin e Politikës për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Fëmijëve e ka PIKA E KONTAKTIT dhe përfaqësuesi i caktuar nga FFK-ja.
- 1.2. Të paktën një herë në vit apo sipas nevojës, FFK do të vlerësojë masat mbrojtëse dhe zbatimin e Politikës së saj mbrojtëse.
- 1.3. Të paktën çdo 4 vjet FFK do të kërkojë shoqatave dhe klubeve vendase të vlerësojnë situatën brenda organizatave të tyre, dhe të japin një pamje të përgjithshme të masave mbrojtëse në të gjithë vendin.
- 1.4. FFK në mënyrë periodike mund të kërkojë një vlerësim të jashtëm të zbatimit dhe përshtatshmërisë së politikës së saj mbrojtëse dhe procedurave të lidhura me të.

V. DISPOZITAT FINALE

Kjo politikë u miratua nga Federata e Futbollit të Kosovës në datën 24.02.2023 dhe hyn në fuqi në të njëjtën datë. FFK kërkon nga të gjitha njësitë dhe zyrat e saj vartëse si dhe administratën për të miratuar cdo udhëzim apo dokument tjetër që vlerësohet e domosdoshme për të zbatuar këtë politikë.

Për pyetje lidhur me këtë politikë, lutemi kontaktoni në email adreseën info@ffk-kosova.com, si pikë kontakti për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve.

Agim Ademi
KRYETAR I FFK-së

Taulant Hodaj
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM